

VENDIM
Nr. 295, datë 8.4.2015

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 31, DATË 22.1.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN DHE MËNYRËN E ORGANIZIMIT E TË FUNKSIONIMIT TË AGJENCISË KOMBËTARE TË BREGDETIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 31, datë 22.1.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Kudo në vendim, emërtimi “... Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit ...” zëvendësohet me “... Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes ...”;

b) Pika 2, e kreut I, “Dispozita të përgjithshme”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Agjencia Kombëtare e Bregdetit e shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë territorin e zonës bregdetare të Republikës së Shqipërisë dhe në zonat, territoret, objektet e veprimtaritë që ndodhen ose zhvillohen, tërësisht ose pjesërisht, apo kanë ndikim në zonën bregdetare të Republikës së Shqipërisë.”.

c) Pika 1, e kreut II, “Organizimi i AKB-së”, ndryshohet, si më poshtë vijon;

“1. AKB-ja ka statusin e drejtorisë së përgjithshme, në nivel qendror, dhe në nivel vendor organizohet në degë rajonale.”.

ç) Pas kreut III shtohet kreu III/1, me këtë përmbajtje:

“KREU III/1

BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

1. Agjencia Kombëtare e Bregdetit, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, ka të drejtë të marrë nga organet e tjera shtetërore, qendrore dhe vendore, të gjithë ndihmën dhe të dhënat e nevojshme për ushtrimin e funksioneve që i janë caktuar.

2. Institucionet shtetërore janë të detyruara të bashkëpunojnë me Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, të shkëmbejnë të dhëna dhe të krijojnë të gjitha lehtësitë për përmbushjen e qëllimeve e të funksioneve gjatë veprimtarisë së saj.”.

3. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama